



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I DËGJIMIT PUBLIK NGA KOMISIONI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR EKONOMI, INDUSTRI, NDËRMARRËSI DHE TREGTI,
MBAJTUR MË 14 QERSHOR 2024**

**SA JAVNE RASPRAVE KOMISIJE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA ZA
EKONOMIJU, INDUSTRIJU, PREDUZETNIŠTVO I TRGOVINU,
ODRŽANE 14. JUNA 2024. GODINE**

**QERSHOR - JUN
2024**

Dëgjimin publik e drejtoi kryesuesi i Grupit punues, z. Driton Hyseni.

KRYESUESI: Të nderuar,

Fillimisht ju dëshiroj mirëseardhje në këtë dëgjim publik. Unë jam Driton Hyseni, me shumicën nga ju veç njihemi. Kryesoj Grupin për Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve në kuadër të Komisionit për Ekonomi, së bashku e kemi menduar konform praktikës që e parasheh dhe Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës që në këtë procedurë, në këtë hap ta kemi një dëgjim publik me të gjitha palët e interesuara me qëllim që të marrim komentet nga ana juaj sa i takon versionit aktual të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit version i cili ka kaluar në lexim të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe që pret tani procedurat e mëtutjeshme parlamentare me qëllim që ta plotësojmë me komente, ta ndryshojmë aty ku e shohim që ka nevojë për tu plotësuar dhe normalisht që konsumatorëve, qytetarëve të vendit të u japim një ligj që në mënyrë adekuate, në mënyrë shumë të përgjegjshme dhe përmbajtjesore ua adreson të gjitha brengat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të tyre si konsumatorë, por normalisht edhe përgjegjësitë që ata duhet të kenë në raport me vetë sjelljen konform Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, sepse edhe për konsumatorët parashihen disa obligime sa i takon mënyrës se si ata qasen në shfrytëzimin e produkteve, blerjen e tyre apo edhe të shërbimeve.

Mirë se erdhe, kolege! Atëherë, besoj që e keni marrë draftin ose më mirë të them ligjin i cili në formën e vetë ka kaluar në leximin e parë, keni pas mundësi edhe pse është jashtëzakonisht voluminoz, ne kemi marrë parasysh faktin që është voluminoz dhe e kemi dërguar pothuajse një javë më herët tek ju me qëllim që ju të keni kohën e mjaftueshme për të shkruar nen për nen për ta analizuar versionin e ligjit dhe normalisht të nxirrni qoftë konkluzionet, qoftë komentet apo propozimet që mund të kemi dhe t'i ndajmë së bashku në këtë dëgjim publik.

Sikur që keni mundur ta përcillni zhvillimin sa i takon votimit në seancë, në lexim të parë të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit e keni pa të qartë edhe nga versionet që keni marrë se ligji trajton sidomos aspektet e të drejtave të konsumatorit në thelb, por sigurisht edhe pjesën e praktikave të padrejta tregtare, synon që në mënyrën më të mirë të mbrojë konsumatorët nga çdo manipulim që mund të jetë prezentë në tregun e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve në vendin tonë. Dhe në këtë drejtim mendoj që nga këndvështrimi jonë si deputetë ligji është jashtëzakonisht përmbajtësor, ndoshta është tentuar që në mënyrë maksimale me të gjitha pjesët e neneve që janë të përfshira në ligj dhe materialet dhe le të themi edhe paragrafët që janë të përfshira në ligj të përmbushet çdo nevojë e mundshme që ka konsumatorin drejt mbrojtjes së të drejtave të tij. Dhe, në këtë drejtim unë do të doja të përgëzoja edhe këtu kemi Ministrinë e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë, zyrtarët prezentë të cilët kanë bërë një punë të madhe në drejtim edhe të plotësimit të ligjit dhe na kanë sjellë një version i cili besoj që përmbush në masë të madhe ato nevoja që konsumatorët kanë.

Mirëpo sigurisht që gjithmonë ka nevojë për komente shtesë, ka nevojë për plotësime andaj jemi këtu për të dëgjuar nga ju komentet që mund të keni në lidhje me versionin aktual të projektligjit me qëllim që deri në leximin e dytë, respektivisht në votimin e dytë në seancë parlamentare kur edhe ligji do të marrë formën e vetë të fuqizimit dhe më pastaj të implementimit ne ta kemi një version sa më të plotësuar.

Kështu që pa humbur kohë unë kisha pas dëshirë që të marrim komentet e juaja, por edhe njëkohësisht edhe një herë të ju falënderoj për kohën që keni ndarë për të dhënë një kontribut besoj që është kontribut qoftë për institucionet që ju përfaqësoni, qoftë edhe për klientët që ju i shërbeni qoftë me produkte a shërbime, apo i keni në fokus të drejtat e konsumatorit. Në këtë drejtim do të doja që fillimisht të ju kërkoja që secili që e merr fjalën të prezantohet dhe të prezantojë, të na informojë për institucionin që përfaqëson dhe normalisht na dërgoni komentet, na jepni komentet këtu dhe të na dërgoni komentet në një fazë të mëvonshme me shkrim nëse veç e shihni të arsyeshme të përpiloni të gjitha komentet me shkrim dhe t'i përcillni tek administrata këtu e komisionit me qëllim që të tillat ne t'i trajtojmë dhe t'i përfshijmë në nenet specifike ku ju mund të keni komentet e juaja.

Edhe një herë duke ju falënderuar nëse veç kolege nuk keni me shtua diçka, atëherë do t'ia kaloja fjalën kushdo që dëshiron i pari ta merr. Kemi përfaqësuesin nga Ministria, atëherë urdhëroni zoti Shala, fjalën e keni.

NIJAZI SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në cilësinë e personit përgjegjës në qoftë se ka mundësi, më lejoni që në emër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit shkurtimisht të paraqesë rëndësinë dhe qëllimin e Projektligjit për Mbrojtjen e konsumatorit.

Pra, siç dihet rëndësia për Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit, duke ofruar zgjedhje të thjeshtë, të drejtë dhe me një kosto sa më të ulët përgjatë shkëmbimit tregtar - konsumatorë. Përndryshe rëndësia e projektligjit është gjithashtu e natyrës ekonomike, sepse mundëson gjithashtu rregullimin e tregjeve, synim drejt një kompeticioni perfekt siç thuhet në termat ekonomik që qon drejt një ekonomie të ashtuquajtur "diferencimi apo konkurrencë të ndërtuar mbi kualitetin dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve, pra një ekonomie që konsiderohet si e shëndoshë për çdo vend si në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Sa i përket vetë projektligjit këtu kemi të bëjmë me çështje të natyrës konkrete legislative, ku rregullohet mbrojtja e konsumatorit, përgjegjësitë e tregtarit, si dhe për cilësitë e konsumatorit kur blen produkte apo shërbime. Për më konkretisht projektligji ka të bëjë me praktikën e padrejta tregtare, etiketimi, paketimet dhe deklaracioni i mallit, shërbimet publike, treguesit e çmimit mbi produktet e ofruara, shitja me aksion, zbritja e çmimeve, shitja në tregjet e hapura, shitja e mallrave me defekte, kontratat me distancë dhe jashtë objekteve afariste, përfshirë blerjet online,

shërbime financiare në distancë, kushtet e padrejta me kontratë, garancitë e produkteve dhe shërbimeve, marrëveshjet e kredive për konsumatorët, pushimet turistike afatgjate, mbrojtja kolektive, bartësit institucional të mbrojtjes së konsumatorit, ankesat e konsumatorëve, si dhe masat mbrojtëse dhe dispozitat ndëshkuese.

Përmes këtyre dispozitave në të cilat kryesisht mbështet në direktivat e BE-së, diku kryesisht plotësisht të transporzuara 12 prej tyre, projektligji ka prioritet të mbrojtë interesat ekonomike të konsumatorëve në çështjet e sigurisë, zgjedhjes, cilësisë, çmimit, larmisë, disponueshmërisë, si dhe mbikëqyrjen dhe transparencës së tregut si diçka që përbën një nga liritë themelore të përcaktuara në Traktatin e BE-së. Sa i përket arsyes dhe qëllimit të projektligjit, analiza paraprake e vitit 2020, përmes koncept dokumentit fillimisht ka identifikuar një numër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit të miratuar në vitin 2018, nuk mbështetë në masa adekuate administrative dispozita ndëshkuese apo penale. Prandaj, ky ndryshim ka për qëllim në rend të parë plotësimin e ligjit në fuqi me masat e nevojshme administrative, dhe dispozitat ndëshkuese për të arritur kështu një efikasitet të plotë të kornizës legislative të mbikëqyrjes së tregut në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.

Analiza e vitit 2020 ka identifikuar gjithashtu nevojën mbi harmonizimin e mëtutjeshëm me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni i BE-së prej se është miratuar Ligjit aktual me numër 06/L-034, në vitin 2018. Komisioni i BE-së atëkohë kishte propozuar seri reformash në fushën e mbrojtës së konsumatorit, e cila eventualisht u kurorëzua me hartimin e direktivës 2019, 21-61 për zbatimin më të mirë të mbrojtjes së konsumatorit. Përmes transpozimit të kësaj direktive janë plotësuar brenda Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit 4 direktiva, ku përveç tjerash me rëndësi të veçantë është transpozimi apo mbrojtja në tregjet apo tregtia elektronike.

Implementimin e politikave të reja për mbrojtjen e konsumatorit paraqet arsyen në iniciimin e këtij projektligji, ku përveç tjerash si rezultat i politikave qeveritare dhe propozimeve nga shoqëria civile janë trajtuar të drejtat e pakicave përgjatë blerjeve të produkteve dhe shërbimeve, detyrat dhe përgjegjësitë të Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit, harmonizimi dhe mbështetja në zbatimin e Rregullores për kthimin e ambalazhit dhe trajtimin e qeseve të plastikës, ndalimi i konsumimit të pijeve energjetike nën moshën 18 vjeçare, mbrojtja kolektive mes tjerash.

Përfundimisht sa i përket rekomandimeve përgjatë konsultimit publik kemi pranuar gjithsej 36 rekomandime përgjatë procesit të plotësim ndryshimit dhe projektligjit, po foli për dy faza nga institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe shoqërisë civile përveç në rastet kur ato kanë qenë në kundërshtim me politikat kompetente institucionale, qeveritare dhe të BE-së, rekomandimet janë adresuar si rekomandime të mirëfillta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Shala! Meqë kemi këtu edhe zyrtarin e ministrisë por ndoshta edhe ju edhe për hir të të gjithë pjesëmarrësve këtu, sepse ne kemi pas një version të ligjit që

vitin e kaluar e kemi trajtuar dhe kemi mbajtur një dëgjim publik për të, ndoshta është mirë meqë jeni këtu do ta bëja edhe unë mirëpo jeni këtu dhe mund të na e specifikoni vetëm pjesën e ndryshimeve që kanë ndodh le të themi në mes të këtyre dy leximeve apo këtyre dy dëgjimeve publike që ne po i mbajmë këtu në Kuvend. T'i specifikojmë vetëm ato pjesë të cilat tani në këtë dëgjim publik që kemi janë risi në projektligj, në referencë të ligjit që veç e kemi pasur dëgjimin publik vitin e kaluar.

NIJAZI SHALA: Unë kisha veçuar dy prej tyre: është harmonizimi me Rregulloren e Ministrisë së Ambientit për kthimin e ambalazhit dhe trajtimin e qeseve plastike, si dhe ndalimin e konsumimeve të pijeve energjike nën moshën 18 vjeçare. Këto janë dy kryesore, përndryshe çështjet e tjera kryesisht janë trajtuar në fazën e parë, përgjatë vitit 2021.

KRYESUESI: Mirë! Faleminderit, zoti Shala! Nëse nuk keni diçka tjetër me shtua sa i takon Ministrisë së Ekonomisë besoj që është një prezantim i ligjit në pika të shkurta e po pres komentet nga ana e pjesëmarrësve të tjerë, kështu që me kënaqësi ndihuni të lirë të jepni komentet e juaja, vlerësimet pa asnjë hezitim.

E ke fjalën!

LUMNIJE HAJDINI: I nderuar kryesues,

E nderuara deputete,

Lumnije Hajdini, nga Aleanca Kosovare e Bizneseve.

Të nderuar përfaqësues nga Ministria MINT,

Banka Qendrore,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Unë jam Lumnije Hajdini nga Aleanca e Bizneseve, për shumë vite Aleanca Kosovare e Bizneseve ka qenë pjesë qoftë e hartimit të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, por edhe në implementim.

Por, para se të filloj me rekomandimet e mija dhe çështjet që kanë të bëjnë me konsumatorin duke e ditë që kohët e fundit krejt mbrohem, por konsumatori është i pambrojtur, kisha kërkuar nga Ministria e Tregtisë, gjegjësisht këtu e kemi Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit, sepse në kuadër të kësaj nuk u përmend është edhe Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorëve që e ka për obligim edhe hartimin e planit për mbrojtjen e konsumatorëve, planit kombëtar që është një plan katër vite, edhe mandej krejt këto lidhen edhe fuzionohen në të gjitha direktivat që i përmendi zoti Nijaziu, këto kanë qenë pjesë ndoshta për shumë vite me radhë, sepse duke qenë se ligjet ne në Kosovë i kemi të harmonizuara me direktivat evropiane, edhe ky plotësim ndryshim është për shkak të kohës është dashur që të hyjë në plotësim ndryshim edhe të fuzionohen direktivat.

Nuk janë vetëm këto dy direktiva që i përmendi zoti Nijaziu për specifikim, domethënë harmonizimi...

Edhe me këto që i përmendi për pijet energjike dhe për blerjet online, mirëpo ka shumë çështje që po përballet konsumatori në Kosovë.

Unë e them shumë herë se edhe bizneset janë konsumatorë. Mirëpo, këtu çka ka ndodhur me Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit, me Këshillin për Mbrojtjen e Konsumatorit? Kisha kërkuar nga zoti Nijaziu që përgjatë këtyre katër viteve të na informojë shkurtimisht, sepse është pjesë që duhet të na tregojë te zbatimi, sepse ne po kemi problem te zbatimi, edhe te qasja edhe te gjithëpërfshirja, qoftë e shoqërisë civile, qoftë e organizatave ekonomike, apo edhe e institucioneve përgjegjëse.

Unë këtu nuk po i shoh disa kolegë që kanë qenë pjesë e këshillit për shumë vite dhe që janë aktualë edhe që kanë dhënë kontributin dhe që kanë qenë shumë të zëshëm për mbrojtjen e konsumatorit. Atëherë, sa ankesa i keni trajtuar, sa janë gjobitur e cilët janë sektorët më potencialë apo bizneset më të pandërgjegjshme që e kanë shkelur të drejtën e konsumatorit?

E dyta, ne këto fuzionime, këto rekomandime do t'i japim në të ardhmen, sepse ne jemi pjesë e kësaj dhe rekomandimet i kemi përcjellë vazhdimisht. Nuk është problemi te plotësim-ndryshimi i ligjit, është problemi te impelmentimi i ligjit. Këtu është krejt fokusi. Kështu që, ndoshta do të jem sa për fillim, mandej do të...

KRYESUESI: Zonja Lumnice, një sqarim të vogël. Neve na duhen komentet e perspektivës suaj sa i takon ligjit aktual, versionit aktual që është kaluar edhe në lexim të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe me kënaqësi presim edhe komentet me shkrim që do t'i dërgoni. Në rrjedhë të asaj që the ti, për të mos mbetur kështu pezull, unë vetëm kisha pasur dëshirë z. Shala ta pyes se nga përvoja juaj, ankesat që kanë qenë të konsumatorëve e që ka mundur të ketë ndonjë hapësirë ligjore që legjislacioni i kaluar nuk ka arritur t'i mbrojtë sa duhet, a janë inkorporuar në versionin aktual që ne e kemi në trajtim tani, me qëllim që ta kemi sa më të plotësuar, edhe atë idenë që maksimalisht të jemi të orientuar, qoftë ne si deputetë, qoftë zyrtarët nëpër institucionet ku punojnë që konsumatorin ta kenë prioritet dhe të drejtat e tyre të jenë të mbrojtura maksimalisht.

NIJAZI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Tash po kthehem pak te logjika, te filozofia e punës për mbrojtjen e konsumatorit, departamentit në këtë rast.

Përmes ligjit rregullohet fusha e mbrojtjes së konsumatorit. Me këtë rast edhe trajtimi i ankesave. Zbatimi i ankesave bëhet përmes inspektorateve kompetente. Ne e rregullojmë pjesën e tregtisë.

D.m.th. nuk rregullojmë cilësitë. Pjesën tregtare, shkëmbimin, konsumatorët tregtarë. Pjesa e ankesave trajtohet në ankesa. Ankesa përgjatë v. 2023, kemi trajtuar diku rreth tre mijë ankesa dhe rreth gjashtëdhjetë për qind prej tyre, po flas për të gjitha inspektoratet kompetente, kryesisht të Inspektoratit të Tregut, po jo vetëm. Diku gjashtëdhjetë prej tyre janë trajtuar. Por, për statistika të sakta, që nuk e kam paramenduar se sot është pjesë e takimit t'i marrë ato statistika. Kështu qëndron. Zbatohet përmes Inspektoratit.

Mendoj që është një pyetje që duhet të drejtohet te inspektoratet, në qoftë se ka ngadalësim të trajtimit të ankesave.

KRYESUESI: Megjithatë, ju e përcillni këtë plotësimin.

NIJAZI SHALA: Po i kemi statistikat.

KRYESUESI: Mund të na i përcillni, mirëpo nuk është pjesë e këtij dëgjimi publik specifikisht. Deputetja Bunjaku-Rexhepi e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit kryesues!

Gjithë ju të pranishëm,

Ky ligj është një plotësim-ndryshim në disa nene. Tash, ne dhe ju këtu që jeni prezentë, po na intereson specifikisht, cili nen p.sh. duhet ndryshuar apo të plotësohet për t'i dalë në ndihmë konsumatorëve, apo në të mirë të konsumatorëve.

Tash, sa i përket implementimit dhe ankesave, e tha edhe kolegu, po është pjesë e inspektoratit dhe ka shumë ligje në Kosovë që janë mirë të shkruar, por pak të zbatueshme, por për zbatueshmërinë e ligjeve, nuk është këtu tema. Është tema të na tregohet specifikisht, cilin nen duhet plotësuar-ndryshuar, që është në favor të konsumatorit. Kaq neve na intereson.

Sa i përket rëndësisë së këtij projektligji, tutje ne veç e kemi të njohur. Vitin e kaluar qysh e di unë është bërë ky ligj me disa ndryshime që tani duhet plotësuar, pikërisht ato na i propozoni neve dhe ne si deputetë e shohim mundësinë se çka të bëhet.

Mirëpo, secili propozim i juaj të mos bie ndesh me një dispozitë tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit deputete!

Zonja Lumnije nëse veç jeni dakord, mund të na i përcillni me shkrim komentet e Aleancës.

LUMNIJE HAJDINI: Atëherë, unë kërkoj falje, mirëpo duke e ditur, për hir, mbase janë mediat, unë them se në vend se Ministria e Tregtisë, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve, gjithmonë kur ka takime për të drejtat e konsumatorit, duhet të specifikohet,

sepse ju e thatë përmes inspektorateve, mirëpo Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve e ka një numër thirrës për aneksa që është 080011000 që këtë duhet potencuar. Ministria nuk shkon përmes inspektorateve, ajo shkon mandej kur ka shumë sektorë që shkojnë përmes qoftë Inspektorati i Punës, qoftë Inspektorati i Tregut qoftë Inspektorati i Ushqimit dhe Veterinarisë.

Te neni 116, ankesat e konsumatorëve, te neni: zgjidhja e ankesave 117. Te neni 118: kërkesa për mbrojtjen e konsumatorit. Të gjitha këto nene kanë shumë rëndësi, se unë jam shumë e vetëdijshme që ne jemi këtu sot për specifikim, mirëpo krejt esenca e ligjeve, sepse jemi duke folur për mbrojtjen e konsumatorëve që janë taksapaguesit e fundit dhe që janë pjesë edhe e financimit të buxhetit të Kosovës dhe që duhet një trajtim i dinjitetshëm.

Ju e thatë që për vitin 2023 kanë qenë 3 000 ankesa. Po dua të ndërlidhem, se kjo shumë ka rëndësi edhe për organet zbatuese, qoftë institucionet, Ministria e Tregtisë, qoftë Qeveria apo edhe grupet parlamentare. Sepse, deputetët e Kosovës nuk i dinë ku ndodh problemi, si iniciohet problemi. Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorëve, planprogrami për mbrojtjen e konsumatorëve duhet të aprovohet në Qeveri, Qeveria duhet ta delegojë në Parlamentin e Kosovës.

Çka ka ndodhur? A kemi matje për katër vite, sa ka qenë zbatueshmëria e planit të programit për mbrojtjen e konsumatorëve? Jo. Sepse, jemi dëshmitarë, kërkoj falje, mirëpo ky është një diskutim përmbajtjesor që duhet ta kemi parasysh, sepse gjatë kohës së pandemisë, apo kur po kemi ndonjë fatkeqësi, dhëntë Zoti të mos kemi më, mirëpo më kujtohet siç e përmendi z. Nijazi, po përmend 3 000 ankesa, mirëpo mos të harrojmë në vitin kur ka ndodhur koha e pandemisë, kam qenë pjesë e procesit dhe numrat, çka ndodh, kapaciteti në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve me tre-katër veta. Nuk e di, ndoshta tash është shtuar numri. Nuk ka kapacitet monitorues, nuk ka kapacitet për trajtimin e ankesave, e para.

E dyta, që lidhet me temën dhe me nenin. E treta, është dashur që ta kemi, është dashur atëkohë që përmes Administratës Tatimore të Kosovës, përmes ATK-së ta japim edhe një numër ku njëmbëdhjetë mijë raste janë trajtuar nga Administrata, në vend që të trajtohen nga Ministria e Tregtisë e Industrisë, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve, janë trajtuar nga Administratës Tatimore të Kosovës.

Mirëpo, çka duhet të jetë në fokus, është edhe te Inspektorati i Ushqimit dhe Veterinës, sepse ka këtu sidomos në këtë sezon që jemi tash në verë, duhet ta kemi shumë parasysh, nuk është vetëm që i the dy direktiva, pijet energjike, janë produktet e mishit, janë shumë sektorë. Ndoshta, te Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve që nuk është te financimi, të rritet forma e buxhetimit të financimit nga Qeveria e Kosovës për Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në mënyrë që të ketë mundësi që ta bëjë monitorimin dhe identifikimin e trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

Edhe një fjalë shumë të shkurtër, edhe po e përmbyll. Për shkak se ne si AKB, gjatë gjithë kohës jemi pjesë për mbrojtjen e konsumatorëve, se edhe bizneset janë konsumatorë, qoftë në shërbime të ndryshme si energjia, shërbimet e ujit, mbeturinat e të gjitha këto, targetojnë një mori çështjesh që duhet për diskutim. Mirëpo, a është bërë sa duhet? Nuk është bërë asgjë. Për shkak të kapaciteteve.

E fundit, sepse këtu lind edhe ekonomia informale, te kontrata që ishte jashtë. Ne e kemi një analizë tash që dyzet për qind është rritur informaliteti, sidomos edhe te arkat fiskale që nuk po përdoren kuponët fiskalë, sepse kuponi fiskal është siguri për konsumatorin në rast se i ndodh diçka që e merr një shërbim, qoftë në gastronomi, qoftë në ndërtimtari, qoftë në shërbimet e tjera. Unë kërktoj falje, sepse jemi pjesë, jam e vetëdijshme që kam dalë pak prej teme, mirëpo për shkak të zbatueshmërisë, sepse ne nuk jemi këtu të vijmë vetëm të japim disa rekomandime, ky apo ai nen, mirëpo çalimi kryesor, mosmbrojtja e dinjitetshme e konsumatorit fillon pikërisht nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe gjithë inspektoratet që e kanë për obligim, sepse ne e dimë që nuk ka pasur kapacitete.

KRYESUESI: Faleminderit znj. Hajdini. Sigurisht për pjesën e komenteve që kishte rreth ligjit, qoftë për ngritjen e nivelit të kompensimit dhe këto, i mirëpresim këto komente, janë të regjistruara tani në transkript, mirëpo edhe nëse keni nevojë për ndonjë plotësim të mëtutjeshëm në shkrim, me kënaqësi e mirëpresim si grup pune në kuadër të komisionit.

Gjithashtu dua të qartësoj që është dëgjim publik për ligjin. Nuk e trajtojmë këtë pjesën e monitorimit të aspektit të ligjit deri tani se si ka funksionuar. Sigurisht që ne do të kemi mundësi të kemi një sesion, qoftë të komisionit, në të cilin do të marrin pjesë edhe Njësia për mbrojtjen e konsumatorit në kuadër të Ministrisë, po edhe ju si palë e interesuar me qëllim që të shohim se sa ka qenë numri i ankesave, sa janë trajtuar ato, sa janë përmbushur ato, ndoshta ka edhe ndonjë vonesë në përmbushjen e tyre, të gjitha këto, t'i evidentojmë edhe normalisht t'i adresojmë si çështje.

Mirëpo, nëse nuk ka ndonjë koment nga ana e zyrtarëve të Ministrisë, nuk isha futur në pjesën e çështjeve për të cilat nuk është ftuar ky takim. Për hir të korrektësisë edhe të pjesëmarrësve të tjerë në takim këtu, do të kisha pasur dëshirë pa humbur kohë këtu, t'ua kaloj fjalën pjesëmarrësve të tjerë në lidhje me versionin e ligjit i cili ka marrë votimin e deputetëve në lexim të parë dhe që pritet në javët a muajt në vijim ta kemi edhe në lexim të dytë në seancën e Kuvendit, ku mandej edhe e merr efektin e vet për t'u implementuar në vend. Kështu që lirisht ndihuni të lirë!

Po, patjetër!

PARTIN PRUTHI: Partin Pruthi prej Shoqatës së Bankave. Nuk kemi problem me ligj, në rregull është. S'ka shumë dallim sa i përket kredive konsumuese në këtë ligj prej ligjit që është në fuqi. Veç po na intereson, se ky ligj e transpozon Direktivën e BE-së për kredi konsumuese, e ajo është zëvendësuar vitin e kaluar. Është ndikimi i direktivës së re të transpozohet prej shteteve deri në nëntor 2026. Veç për ta reduktuar burokracinë e Kuvendit, ndoshta është mirë. nuk ka shumë ndryshim direktiva e re prej direktivës së vjetër, veç ta përditësojmë pak edhe ta transpozojmë direktivën e re që është.

KRYESUESI: Ju e dini që ky dëgjim publik po bëhet para se komisioni, respektivisht grupi i punës të shkojë nën për ne dhe ta trajtojë ligjin në aspektin e trajtimit parlamentar siç e kërkon procedura.

Ne do ta kemi këtë hapësirë kohore që Ministria t'i marrë këto komente dhe vërejtje tuaja dhe t'i analizojë dhe nëse e sheh të arsyeshme, së bashku me grupin e punës të marrin vendim që ta shtyjnë përpara dhe t'i vendosin edhe këto direktiva.

Unë jam shumë i pajtimit që çka do që ka dalë nga legjislacioni i BE-së së fundmi, të jetë i inkorporueshëm për atë sa ka mundësi në legjislacionin tonë, e të mos kemi nevojë ne mandej të presim një azhurnim të ri të ligjit le të them në vitet që vijnë. Kështu që, ju faleminderit për komentin!

Patjetër, veç prezentohu!

SELVIJE ÇEKU: Unë jam Selviye Çeku jam udhëheqëse e Departamentin Ligjor.

Pra, mundemi në këto komentet e Shoqatës së Bankave, ashtu qysh e keni pranuar edhe sipas raportin të procesit të konsultimit, në qoftë se ka mundësi ju lutem të na e dërgoni me shkrim numrin e direktivës dhe ta shohim, edhe kaq.

KRYESUESI: Ne do t'jua përcjellim transkriptin e dëgjimit publik edhe mandej i shihni të gjitha komentet që janë, edhe referencat mund t'i merrni edhe nga transkripti, por sigurisht që zoti Pruthi do ta përcjellë edhe me shkrim specifikisht direktivën. Faleminderit! Zoti Shala, urdhëro!

NIJAZI SHALA: Shkurtimisht, në aspektin teknik administrative se si funksionon, për atë sa e kuptoj unë, te pjesa e BE-së. Shtetet anëtare e kanë deri në vitin 2026. Si proces, si ligj e kemi filluar në vitin 2020 me koncept-dokumentin. Në atë kohë nuk ka qenë. Domethënë, është për shtetet e BE-së deri në vitin 2026 do ta bëjnë raportimin se sa e kanë zbatuar atë direktivë të përgjithshme, shtetet anëtare.

Për shtete jo anëtare është deri në vitin 2031. Rasti i kësaj direktive, në këtë rast, por nuk është e vetmja. Këto janë në qarkullim tërë kohën. Janë edhe direktivat e tjera.

KYRESUESI: Mirë që u sollën edhe këtu në prezencë, se mandej në grup punës, zoti Pruthi mund të mos jetë. Shumë mirë. Faleminderit! Po, zoti Florent!

FLORENT MEHMETI: Përshëndetje për të gjithë! Unë jam Florent Mehmeti, jam anëtar i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës. Faleminderit, kryesues! Deputetë, të gjithë pjesëmarrës!

Desha të ndërlihem pak a shumë, diçka tjetër desha të them, por po ndërlihem fillimisht me parafolësin që e përmendi, direktivat dhe hyrja në fuqi. Faktikisht ajo është për shtetet anëtare deri në vitin 2026 që e kanë obligim transpozimin. Kështu që, deri në atë kohë mund të shkohet me transpozimin e direktivave aktuale dhe në momentin e hyrjes në fuqi, dhe pjesë e tjera kur obligohemi si shtet jo anëtar i Bashkimit Evropian, atëherë mundemi me plotësim-ndryshim ta rregulloni këtë çështje sa i përket Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorëve.

Këtu u përmend disa herë plotësim-ndryshimi i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, por në bazë të materialit që e kemi marrë shihet që është projektligj, nuk është plotësi-ndryshim i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, gjë që dallon.

Disa çështje shkurtimisht sa i përket përmbajtjes së projektligjit. Ajo që më ra në sy, në bazë...Unë e di që është projektligj. Nuk është plotësim-ndryshim a po. Në material shkruan Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit. Përveç kësaj, faktikisht në bazë të një standardi që faktikisht në legjislaturën e 8-të, po edhe më herët ka filluar të zbatohet, e që është në pajtueshme edhe sa i përket ngritjes së cilësisë së ligjeve dhe mënyrës së delegimit të Kuvendit si organ legjislativ tek Ekzekutivi, është që edhe te përmendja e akteve të përmenden aktet nënligjore që do të nxirren nga sponsoruesi apo iniciuesi i projektligjit.

Këtu në përfundim, nëse nuk gabo, neni 143 e përmend që ministria do t'i nxjerrë aktet nënligjore, por cilat nuk përmenden, në një afat prej 12 muajve. Kështu që ndoshta do të ishte mirë që gjatë grupit punues të kihet parasysh dhe të evidentohen dhe të saktësohen aktet nënligjore që do të obligohet ministria e linjës për t'i nxjerrë në zbatim të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

Më tepër. Domethënë, sa përket gjobave, te Ligji për kundërvajtje i keni gjobat faktikisht dhe besoj që siç i pashë janë në përputhshmëri të plotë me Ligjin për kundërvajtje. Ju e keni edhe një paragraf të dytë te neni 29, ku saktësohet që përveç në disa fusha ku mund të shkoni me dyfishimin e gjobave, ndër to është edhe sa i përket shëndeti publik, po edhe te mbrojtja e konsumatorit.

Domethënë, aty ku ju mendoni që ia vlen të ngritën gjrobat, atëherë ju edhe mund të shkoni me ngritjen apo dyfishimin e vlerës ku është e përcaktuar si gjobë. Po është e vërtetë, pati shumë direktiva. Ne personalisht nuk i kam pasur tabelat e përputhshmërisë. Besoj që përderisa thuhet që është në përputhshmëri të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ashtu të jetë.

Sa i përket pjesës tjetër, faktikisht edhe ne si Autoritet i Konkurrencës do duhej ta kishim ndonjë bashkëpunim më të madh, madje edhe përmendet edhe te disa dokumente të Bashkimit Evropian që duhet të kemi një, faktikisht, një memorandum bashkëpunimi sa i përket kësaj pjese për mbrojtjen e konsumatorit.

Kështu që, ne besoj që në të ardhmen, kryetari...edhe ne si anëtarë të komisionit të fillojmë një bashkëpunim, faktikisht në kuptim të evidentimit edhe të nënshkrimit të një memorandumit të bashkëpunimit. Ose, nëse ka memorandum të bashkëpunimit, faktikisht të bëhet update në kuptim të kësaj. Faleminderit!

NIJAZI SHALA: Për akte nënligjore që nuk janë cekur. Po, janë cekur, i nderuar...Tash, m'u kujtua është për etiken. Për shembull, është rregullohet me akt nënligjor. Mandej ka edhe aktet të tjera, mirëpo...edhe për reklamimin janë me kat nënligjor.

Mandej, edhe këto dispozitat ndëshkuese janë shkruar sipas Ligjit për kundërvajtje. Si grup punues e kemi paraparë që mendoj që janë në rregull.

KRYESUESI: Për hir të procesverbalit është mirë që nëse e sheh të nevojshme që të jetë pjesë e procesverbalit.

PARTIN PRUTHI: Në fund që shkruan, ministria duhet të nxjerrë aktin nënligjor në afat 12 muaj. Obligime ka edhe BQK-ja që t'i shkruaj disa akte nënligjore.

NIJAZI SHALA: Jo në këtë rast se nuk janë pjesë...Kreditë konsumuese dhe tregtia online, shërbimet financiare nuk janë prek përmes këtij projektligji. Për atë edhe nuk...qenë pjesë e grupit punues në këtë rast.

Më 2028 që kanë qenë 3 kanë kaluar te ju, se i keni të mbuluar me rregullore.

(pa mikrofon nuk dëgjohet qartë) Edhe s'kemi asnjë problem.

(pa mikrofon nuk dëgjohet qartë) Nejse, Venera ka qenë pjesë e grupit punues në atë kohë.

KRYESUESI: Zonja nga Banka Qendrore e Kosovës, urdhëroni!

VENERA PRIZRENI: Jam Venera Prizreni udhëheqëse e devizionit për legjislacion dhe rregullativ. E kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe nga ai ekzistues nuk kemi vërejtur që ka ndonjë dallim sa u përket detyrave dhe autorizimeve të Bankës Qendrore.

Ndërsa, po ashtu edhe për trajtimin e ankesave nuk është në mënyrë të veçantë e përmendur që Banka Qendrore mund të nxjerrë me akt nënligjor. T'i rregullojë ankesa e konsumatorëve, të institucioneve financiare që i rregullon dhe i mbikëqyrë.

Është e përcaktuar veç që ndërmer masa administrative, ashtu siç ishte. Po ashtu çka kemi vërejtur. Kemi vërejtur që mungon një përkufizim se çka nënkupton normë variabile. Për normë fikse dhe normë vjetore ishte përkufizimi.

KRYESUESI: Te pjesa e përkufizimeve.

VENERA PRIZRENI: Po ashtu te pjesa e nenit 87 që është informacion parakontraktual, paragrafi 1.13 përmendet si term ndoshta është si çështje teknike edhe përdorimit të termeve. Gjorbë të pagueshme. Domethënë, në raste kur norma e a plikueshme në interesit në rast të vonesave të Kësteve dhe mënyrën e llogaritjes së saj. Tarifë ndëshkuese. Se gjorbë ndoshta mund ta ketë një kuptim tjetër. Ndaj, klientëve nuk besoj që mund të lëshojnë gjoba. Ndoshta ka mbetur gabim teknik.

KRYESUESI: OK! Neni 87, 1.13 është. Faleminderit, zonja Prizreni!

Siç e thatë edhe ju, dhe siç e thashë edhe në fillim që procedura parlamentare e kërkon edhe një dëgjim publik me qëllim që ta shterojmë çdo mundësi që ta kemi një ligj sa më mirë të plotësuar, dhe normalisht që e dimë meqë është mbajtur një dëgjim publik vitin e kaluar dhe kemi pasur pothuajse versionin me pak plotësime tani që ka ardhur.

Mirëpo, e kemi pasur versionin pothuajse të kompletuar të ligjit, ne e kemi parasysh këtë faktin që nuk ka shumë vend për komente, mirëpo prapëseprapë kemi pasur dëshirë që ta kemi dëgjimin publik sot, dhe të marrim edhe ato pak komente që ka mundësi të jepen nga palët e interesuara me qëllim që siç e thashë edhe në fillim, të drejtat e konsumatorit tamam të mbrohen ashtu siç kërkohet me të gjitha direktivat evropiane dhe normalisht ta kryejmë një obligim tonin që e kemi karshi tyre.

Po zoti Shala nëse keni për të shtuar diçka!

NIJAZI SHALA: Është një çështje që u trajtuar brenda projektligjit të miratuar 2018. Domethënë, përgjatë vitit 2016-2017 edhe nga Banka Qendrore, se realisht ka qenë me ta, po ku e di, neve na e dha si përgjegjësi Zyra e BE-së, e rekomanduam. Pastaj ne filluam edhe nga

Banka Qendrore ishin dy të Zyrës Ligjore, edhe është komplet me direktivë. Është shumë me direktivë, se prej shoqatës së bankave.

Se është edhe pjesa profesionale. Tash, ne jemi pjesa ekonomike, por është edhe specifike. Sektori është pjesa komerciale edhe është shumë zor të përballohen. Sidomos ligji më 2018 kemi pranuar diku rreth 80 komente prej shoqatës së bankave. Përndryshe, do të ishte shumë problem të mos ishte 100% me direktivë. E aty i kemi pasur dy të Bankës Qendrore, dy aktorë.

Kjo pjesë, në Ligjin aktual nuk është prekur. A po më kupton, është komplet ashtu. Është e njëjta.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju ftoj të tjerëve që jeni pjesë e tryezës nëse veç keni vullnetin ta jepni ndonjë kontribut shtesë apo nëse janë përmbushur të gjitha ato që i menduat t'i plotësoni në këtë tryezë. Atëherë, edhe mund ta konsiderojmë si të përmbledhur pjesën e dëgjimit publik. Nuk kemi ndonjë interesim tjetër për të dhënë ndonjë koment shtesë sa i takon ligjit. Atëherë, duke ju falënderuar edhe njëherë për kohën që keni ndarë që të jeni pjesë e dëgjimit publik...Nëse ke diçka për të shtuar! Mirëserdhe deputet! Në veç e konsumuam pjesën e dëgjimit publik pothuajse.

Nëse nuk keni diçka për të shtuar, ose keni interesim. Së bashku me dy kolegët deputetë, zonjën Bunjaku-Rexhepi dhe zotin Lekaj, dëshirojmë t'ju falënderojmë të gjithëve për prezencën tuaj, për kontributin qoftë në këtë dëgjim publik, por edhe në dëgjimet e mëparshme publike sa i takon Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

Ne së bashku me kolegët këtu, me zyrtarët e ministrisë do t'i trajtojmë me shumë kujdes të gjitha komentet që ju i dhatë, edhe ato që do t'i përcillni me shkrim, dhe normalisht që qytetarëve të vendit, konsumatorëve, kompanive, të gjithëve që e kanë vullnetin e madh që konsumatorin ta kenë prioritet në mbrojtjen e detyrave dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre, ne t'u japim një ligj sa më përmbajtjesor dhe sa më efikas.

Edhe një herë, faleminderit shumë! I mirëpresim komentet tuaja deri më 21 qershor. Armendi po e sheh si datën më të përshtatshme. Pra, një javë kohë. Pastaj pas komenteve ne do të fillojmë si grup pune me trajtimin e ligjit nën për nen dhe besoj që edhe do të mund të keni informacion lidhur me progresin, e së shpejti ta kemi edhe në seancë, ku besoj që edhe opozita do të bashkohet me votat e saja dhe ta kalojmë sa më lehtë Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Ju falënderoj edhe një herë e mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*